

# DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

## BULETINI INFORMATIV

### QERSHOR 2023



Intervistë e Drejtorit të Përgjithshëm,  
të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas  
Z.Ergys Qirici,  
dhënë për Radio Televizionin Shqiptar -  
RTSH24

Shiko intervistën e plotë tek linku: <https://www.youtube.com/watch?v=yHKHGliIW8Q>

**Nënshkrimi i marrëveshjeve për sigurimin e ambienteve pa kundërshtëpërblim, për hapjen e 6 Qendrave të reja të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, në Tropojë, Përmet, Mat, Pukë, Kurbin dhe Kavajë.**



Janë nënshkruar marrëveshjet për sigurimin e ambienteve pa kundërshtëpërblim, për hapjen e 6 Qendrave të reja të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, në Tropojë, Përmet, Mat, Pukë, Kurbin dhe Kavajë, pranë ambienteve të ish Gjykatave të Rrethit Gjyqësor të mbyllura me miratimin e Hartës Gjyqësore.



Janë shpallur dhe njoftuar 2 specialistët fitues të konkurrimit për Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tropojë dhe Përmet.



Në kuadër të informimit & ndërgjegjësimit të personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, statusi i të verbrit  
Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore u angazhuan në zhvillimin e aktiviteteve dhe takimeve përgjatë muajit Qershor 2023

## Gjirokastrë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Gjirokastrë, më datë 08.06.2023, zhvilloi pranë ambienteve të



Këshillit të Qarkut, Gjirokastrë, një aktivitet ndërgjegjësues dhe informues për personat të cilët përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar (PAK). Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin Kryetarë të (PAK) Gjirokastrë, Përmet, përfaqësues të Avokatit të popullit, persona të cilët përfitojnë nga pagesa për (AK), si edhe me pjesëmarrjen e medias lokale RTGJ.



## Fier

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier, në datën 02.06.2023 zhvilloi një takim në ambientet e qendrës, me Kryetarin e Shoqatës së Invalidëve, Patos, Z.Nikollaq Gollosi. Gjatë takimi pati diskutime rreth problematikave të ndryshme që kjo kategori përballëj, të referuara nga z. Gollosi, duke analizuar disa prej tyre, si dhe ju bë me dije për referim të rasteve të tjera në dhënien e kosulences juridike dhe përfitim të ndihmës juridike, si një prej kategorive të veçanta, përcaktuar nga Ligji 111/2017.



## Pogradec

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec, në datën 14.06.2023, zhvilloi një aktivitet me pjesëmarrjen e përfaqësueses së Avokatit të Popullit, zj. Burbuqe Ngracanj dhe përfaqësuesin e shoqatës së invalideve Pogradec, z. Gëzim Shukle. Në takim u diskutua dhe për problematikën konkrete ku përfitues kanë qënë personat me aftësi të kufizuar dhe përfitimi i ndihmës juridike nga Qendra, konkretisht përfitimi i diferencave të papaguara për periudhen 2005-2010.



## Kukës

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Kukës, zhvilloi një takim me individë të kategorie përfituese, personat me aftësi të kufizuar, si dhe me Z.Mustaf Lugjaj, kryetarin e Shoqatës së Invalideve Kukës, pranë ambienteve të Prefekturës Kukës.

Gjatë aktivitetit u diskutuan për problematikën dhe vështirësitë që kjo kategori përfituese ka.



Në kuadër të informimit & ndërgjegjësimit të personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, statusi i të verbrit

Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore u angazhuan në zhvillimin e aktiviteteve dhe takimeve përgjatë muajit Qershor 2023

## Durrës

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Durrës, në datën 01.06.2023 zhvilloi aktivitetin informues dhe ndërgjegjësues në Qendrën Komunitare për Fëmijë me aftësi të kufizuar, Bashkia Durrës. Në këtë takim pjesëmarrës kanë qënë përfaqësues të Qendrës, prinder dhe fëmijet me aftësi të kufizuara.



## Shkodër

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Shkodër, zhvilloi takimin në kuadër të Ditës Botërore të Personave me Aftësi të Kufizuar, në ambjentet e Qendrës 'Shtëpia Rregulltare e Bashkësisë Misionarët e Dashurisë Kontemplative' me seli në Bushat Bashkia Vau Dejës".

## Lezhë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lezhë, zhvilloi një takim me shoqatën e invalideve, me qytetarët me aftësi të kufizuar, të cilët u informuan rreth ligjit 111/2017, si kategori e veçantë përfituese. U trajtua edhe rasti i z. Kol Koleci, përfitues nga statusi i të verbërit, i cili u orientua për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tij nëpërmjet ndërmjetësimit.



## Lushnjë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lushnjë, në datën 01.06.2023 organizoi në bashkëpunim me Qendrën e Zhvillimit dhe spitalin Lushnjë, një aktivitetet informues me nenat, të cilat kanë fëmijë me aftësi ndryshe, duke i informuar se mund të drejtoheshin tek Qendra për problemet e tyre ligjore.

Në këtë takim u diskutua edhe për problemet rreth shërbimit social dhe adresimet tek kempit epror.

## Tiranë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë, në datën 06.06.2023 organizoi në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë, kryetarin Sajmir Farrici, së bashku me anëtare të Shoqatës, takimin në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë, ku krahas diskutimeve mbi përmiresimin e dhënies dhe ofrimit të shërbimit, shërbeu edhe për asistimin e dhënies së ndihmës juridike



**Në kuadër të informimit & ndërgjegjësimit të personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, statusi i të verbrit Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore u angazhuan në zhvillimin e aktiviteteve dhe takimeve përgjatë muajit Qershor 2023**

## **Korçë**

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë, në datën 06.06.2023 zhvilloi një aktivitet me persona përfitues nga pagesa për aftësinë e kufizuar dhe personat me statusin e të verbrit.

Në takim u diskutuan dhe mbi çështje të tjera që kjo kategori është përballur, si çështjet e pronësisë, përdorimi i portalit E-albania, vërtetimet e paafësisë, etj.



## **Berat**

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Berat, në datën 05.06.2023 zhvilloi një aktivitet me Shoqatën e Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe me Shoqatën e Para/Tetraplegjikëve. Në këtë takim pjesëmarrësit u informuan mbi Ligjin Nr.111/2017 "Për Ndhmë Juridike të Garantuar nga Shteti" si dhe shërbimet që ofron QSHNJP Berat.



## **Vlorë**

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë, më datë 01.06.2023, në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit, zhvilloi një takim me z.Hysen Muhametaj, Kryetar i Shoqatës së Invalidëve Vlorë dhe qytetarë që kanë statusin e invalidit, të cilët ishin prezent. U diskutua mbi mundësinë e bashkëpunimit, mbi organizimin e një takimi të përbashkët me Kryetarin e Bashkisë Vlorë dhe përfaqësuesin e kompanisë së transportit publik qytetas Urban-Trans sh.a, për të reflektuar dhe propozuar zgjidhje mbi problematikat më të shpeshta në përditshmërinë e personave me statusin e invalidit, që rëndojnë më tej situatën e tyre.



## **Elbasan**

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Elbasan, në datën 02.06.2023 organizoi një aktivitetet informues, në kuadër të realizimit të një aktiviteti me personat me aftësi të kufizuar, pranë ambienteve të Shoqatës 'Mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Me pjesëmarrjen e prindërve të personave me aftësi të kufizuar, Drejtoreshën e Shoqatës dhe Drejtorin e Shërbimit Social Librazhd.

# Aktivitetet e tjera të organizuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, gjatë muajit Qershor 2023



QSHNJP Shkodër

Në datat 06.06.2023 dhe 07.06.2023 Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Shkodër, mori pjesë në takimet e organizuar nga Organizata 'Gruaja te Gruaja', në kuadër të projektit të financuar nga UNDP për "Ndhmën Juridike Parësore të Garantuar nga Shteti", të cilat u zhvilluan në Njësinë Administrative Hajmel, Bashkia Vau Dejes me banorë të zonës dhe në ambientet e Qendrës së Formimit Profesional.

Në datën 08.06.2023 Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Berat, në bashkpunim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë, Bashkia Berat zhvilluan një aktivitet informues me nxënësit e klasës së 5-të të Shkollës "1 Maj". Në këtë aktivitet nxënësit u informuan në vija të përgjithshme mbi Ligjin Nr.111/2017 "Për Ndhmë Juridike të Garantuar nga Shteti" si dhe mbi shërbimet që QSHNJP Berat Ofron.



QSHNJP Berat



QSHNJP Vlorë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë, në datën 19.06.2023, në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit zhvilloi një aktivitet informues pranë "Shtëpisë së Fëmijës" Vlorë. Ky aktivitet kishte në fokus informimin e kujdestarëve ligjor të fëmijëve mbi të drejtat dhe mundësitë që i ofron ligji (neni 11 pika ç), për çështjet që lidhen me fëmijët nënkujdestari apo qëkërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor. Në fund të takimit nga ana e punonjësve të QSHNJP Vlorë u shpërndanë disa pako me dhurata për fëmijët që jetojnë në këtë institucion



QSHNJP Vlorë

Në datën 19.06.2023, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec, mori pjesë në workshopin e zhvilluar me anëtarët e ETN, së MKR Pogradec, të organizuar nga Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin, në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec dhe me mbështetjen e UNFPA. U diskutua mbi arritjet, praktikat, veshtirësitë, sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e funksionimit të këtij MKR në përpunje dhe me kuadrin ligjor, politikave mbi trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, ku një ndër aktorët kryesorë të kësaj marrëveshje është dhe Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas, si institucion që i vjen në ndihmë kategorive të veçante, viktimave të dhunës në familje.



QSHNJP Pogradec

# Aktivitetet e tjera të organizuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, gjatë muajit Qershor 2023

Në datën 23.06.2023, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Shkodër, mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Organizata të Ndryshëm dhe të Barabartë, me temë *“Sfidat dhe mundësitë për ofrimin e ndihmës juridike falas për viktimat e krimit”* në kuadër të projektit të D&E *“Rritja e kapaciteteve për ofrimin e ndihmës juridike falas për viktimat e krimit dhe individë të tjerë vulnerabël nëpërmjet fuqizimit të profesionistëve të ligjit dhe avokatisë “pro bono”*.



QSHNJP Shkodër



QSHNJP Pogradec

Në datën 26.06.2023, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Pogradec, Drejtoria e Shërbimit Social, Sektori i Përfshirjes Sociale, Barazisë Gjinore dhe Mbrojtjes së Fëmijëve, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Egjiptianëve të Ballkanit.

Ishte një ditë aktiviteti dhe angazhimi intensiv, gjatë të cilës patëm një krahasim të frytshëm dhe një shkëmbim interesant idesh me një vlerë të veçantë profesionale.



QSHNJP ELbasan

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Elbasan, mori pjesë në takimin e organizuar nga Rektori Universitetit të Elbasanit Prof.Dr Z.Skënder Topi dhe Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Z.Kreshnik Ajazi, me temë *“Sfidat e Drejtësisë Shqipëtare nga Kanuni i Zhurisë deri tek Reforma në Drejtësi”*. Të pranishëm ishin Drejtuesi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Z. Alfredo Balla, Inspektori i lartë i Drejtësisë, Z.Artur Metani, Rektori i Universitetit të Tiranës, Prof.Dr Z.Artan Hoxha, Kryetaria e Gjykatës e Shkalles së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Znj. Matilda Fetau, Drejtori Policisë Elbasan Z.Illir Proda, gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë të Dhomës Avokatisë Elbasan, por dhe studentë e përfaqësues institucionesh.

